VENDIM
Nr. 38, datë 25.6.2014

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "MBI MINIMUMIN E REZERVËS SË DETYRUAR MBAJTUR NË BANKËN E SHQIPËRISË NGA BANKAT"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 19 dhe nenit 43, shkronjat "a" dhe "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Mbi minimumin e rezervës së detyruar mbajtur në Bankën e Shqipërisë nga bankat", miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 16.5.2012, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 4 "Përkufizime", pas shkronjës "g", shtohet shkronja "gj" me përmbajtje si më poshtë:

"Remunerimi i tepricës në llogarinë e rezervës së detyruar" – është interesi që paguhet nga bankat për Bankën e Shqipërisë për tepricën e mbajtur në këtë llogari.

b) Në nenin 4 "Përkufizime", shkronja "g" ndryshon sipas përmbajtjes së mëposhtme:

"Remunerimi i rezervës së detyruar" – është shuma e interesit që paguhet nga Banka e Shqipërisë për bankat, për rezervën e detyruar të mbajtur nga këto të fundit në Bankën e Shqipërisë.

c) Pas nenit 12 me titull "Remunerimi i rezervës së detyruar", shtohet neni 12/1 me titull "Remunerimi i tepricës në llogarinë e rezervës së detyruar", me përmbajtje si më poshtë:

1. Teprica e llogarisë rezervë në lekë është diferenca e gjendjes mesatare në llogarinë rezervë së bashku me "cash në kujdestari" në periudhën e mbajtjes me rezervën e detyruar, në ditën e fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar, por jo më e vogël se niveli minimal i tepricës.

2. Teprica e llogarisë rezervë në valutë është diferenca e gjendjes në llogarinë rezervë me rezervën e detyruar, e llogaritur çdo ditë, por jo më e vogël se niveli minimal i tepricës.

3. Banka e Shqipërisë remuneron tepricën, në gjithë shumën e saj, vetëm në rastet kur tejkalohet niveli minimal i saj, ku si i tillë konsiderohet shuma për të cilën bankat nuk remunerohen. Si nivel minimal për rezervën e detyruar në lekë, euro dhe USD konsiderohen përkatësisht shumat 50 milionë lekë, 500,000 euro dhe 500,000.00 USD.

4. Norma e remunerimit të tepricave në llogarinë e rezervës së detyrueshme në lekë, euro dhe USD përcaktohet me vendim të Këshillit Mbikëqyrës dhe u komunikohet bankave.

5. Interesi për remunerimin e tepricës llogaritet sipas formulës së përcaktuar në pikën 3 të nenit 12 të rregullores.

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani